# DËSHMI ARKIVI

**A-423686**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Algoritmi, Rama ndan fjalën e autorit Yuval Harari: Synohet angazhimi, jo e vërteta – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/algoritmi-rama-ndan-fjalen-e-autorit-yuval-harari-synohet-angazhimi-jo-e-verteta/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:12:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 30 gusht 2026, 10:19:01 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ff09f2fd5647c2ad1ac754e64956238d903eacd37a7e0634db71831f93f99dcd` |
| TEKSTI | `7f82a1416722e39ed2cf296d48d1d75347261761ec06882178b7243a59cd1da6` |
| PAMJA | `8c1f51699ba43f99ced6824985c74d62cc8815b68e871c763cccdd0548d62784` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `09f3e3ea76d32e2a1da1ca93ad724fbe6a54ddb8b85a4acebd96da45364288e4` |
| E MËPARSHMJA | `d690ed67291304384d47de2d06bb60181c3368e4987ad608abf7237f0b94437f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/09f3e3ea76d32e2a1da1ca93ad724fbe6a54ddb8b85a4acebd96da45364288e4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Sipas Hararit, algoritmet e Facebook, X dhe TikTok nuk janë ndërtuar për të nxjerrë në pah të vërtetën, por për të rritur angazhimin e përdoruesve dhe kohën që ata kalojnë në platforma.

"*Algoritmit te rrjeteve sociale iu dha si objektiv jo krijimi i besimit apo krijimi i së vërtetës, por krijimi i angazhimit. Objektivi që iu dha algoritmit të Facebook-ut, algoritmit të X-it, Tik-tokut është të rritet ndërveprimi i përdoruesve. Dhe kjo tingëllon bukur. 'Angazhim' duket si diçka e mirë, por ajo që do të thotë në të vërtetë është se algoritmet eksperimentuan mbi miliona e miliarda njerëz si mbi kavie njerëzore për të parë si t'i bëjmë njerëzit më të angazhuar, si t'i bëjmë njerëzit të kalojnë më shumë kohë në platformë dhe të reagojnë më shumë ndaj saj*", u shpreh ai.

Harari thotë se algoritmet kanë zbuluar se përmbajtjet që gjenerojnë më shumë reagime janë ato që nxisin frikë, urrejtje, zemërim dhe lakmi.

"Algoritmet zbuluan se mënyra më e lehtë për t'i bërë njerëzit të angazhohen është të shtypësh butonin e urrejtjes ose butonin e lakmisë ose butonin e frikës në mendjen e tyre ,në mendjen njerëzore, sepse urrejtja është jashtëzakonisht angazhuese, frika është jashtëzakonisht angazhuese. Nëse diçka kërcënon jetën tënde, menjëherë je i angazhuar, dhe kështu ata e kanë përmbytur botën. Me urrejtje, frikë, zemërim dhe lakmi. Sot jetojmë në një botë hiper të angazhuar", tha ai.

Sipas tij, ky mekanizëm ka ndikuar edhe në mënyrën se si zhvillohet debati publik dhe politik, duke e mbajtur shoqërinë në një gjendje të vazhdueshme "eksitimi" emocional.

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

vazhdueshme “eksitimi” emocional.

“*Angazhimi është kushëri i afërt me një fjalë tjetër që sot është bërë shumë dominuese që është ‘eksitimi’ që në thelb do të thotë që sistemi yt nervor është vazhdimisht në një nivel shumë të lartë aktivizimi. Natyrisht eksitimi është i mirë në situata të caktuara deri në një farë mase, ashtu si edhe angazhimi është i mirë në situata të caktuara por biologjikisht një organizëm që qëndron i eksituar gjatë gjithë kohës në fund organizmi shembet dhe vdes. Nuk jemi ndërtuar për të qenë gjatë gjithë kohës të eksituar. Unë do të doja të takoja njerëz që më bëjnë të ndihem i qetë, jo domosdoshmërisht të eksituar. Pastaj shikon politikën amerikane, atë izraelite apo thjesht gjithë botën. E gjithë bota është tepër e eksituar*” , u shpreh ai.

Rama, i cili e cilëson Hararin si “një nga mendjet më largpamëse të botës së sotme”, ka zgjedhur këtë pjesë të fjalës së tij në rrjetet sociale, duke ndarë të njëjtin shqetësim për ndikimin e algoritmeve në mënyrën se si njerëzit informohen dhe reagojnë.

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku 3 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku 9 minuta më parë



EKONOMI

**Nafta “kapërcen” 230 lekë për litër,...**

Xhuljana Zhuleku 37 minuta më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme,

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.